



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

## TËRHEQJA E INVESTIMEVE TË HUAJA

## INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN

## MBËSHTETJA E NDËRMARRJEVE TË VOGLA E TË MESME

## KONSULTIMI I PROJEKTLIGJIT TË INVESTIMEVE

## FORUMI NDËRKOMBËTAR PËR SHËRBIMET PUBLIKE

## SHËRBIMET ONLINE PËR TATIMPAGUESIT

## MARRËVESHJE SHQIPËRI-KOSOVË PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT

## PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS

# DITARI JAVOR

23-30 Qershor 2019



Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, ka shpalosur potencialin ekonomik të Shqipërisë dhe ka ftuar investorët suedezë të investojnë në vendin tonë, gjatë pjesëmarrjes së saj në Konferencën e Nivelit të Lartë të Ballkanit Perëndimor në Stokholm. Ministria përmendi sektorët kyç për të investuar dhe mbështetur financiarisht, si turizmi, bujqësia, infrastruktura, ndërtimi dhe energjia, duke theksuar se Shqipëria ofron një ambient të favorshëm për investorët e huaja, ku përmirësimi i klimës së biznesit është konstatuar edhe nga institucione ndërkombëtare. Ekonomia është vlerësuar e qëndrueshme nga institucione prestigjioze financiare si S&P dhe Moody's, me një rritje graduale të parashikuar në nivelin e 4.2 % sipas Bankës Botërore. Papunësia në vitin 2018 shënoi ulje në shifrën 12.3 %, ndërsa pjesëmarrja në forcën e punës arriti 59.6 %, një rekord në rajon.



Shqipëria dhe Gjermania nënshkruan një marrëveshje për ofrimin e asistencës teknike për të mbështetur përgatitjet për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në kapitujt e përzgjedhur ekonomikë të Acquis. Programi ka një vlerë prej 2 milionë eurosh, do të zgjasë tre vjet dhe financohet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatohet nga GIZ. Synimi kryesor është pajisja e anëtarëve të strukturave të ardhshme përgjegjëse për negociatat e Shqipërisë me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme në katër kapitujt kryesorë që kanë të bëjnë me: cilësinë dhe garantimin e sigurisë së produkteve në treg; mbrojtjen e shëndetit dhe të drejtave të konsumatorëve; zhvillimin e konkurrencës së SME-ve; si dhe mundësimin për shoqëritë tregtare dhe individët për t'u vendosur dhe/ose ofruar shërbime lirishet dhe pa u diskriminuar kudo në BE.



Ministria Anila Denaj dhe ambasadori i Italisë z. Alberto Cuttillo ishin pjesë e tryezës së rrumbullakët me temë "Programi i Zhvillimit të SME-ve Italo-Shqiptare në Shqipëri". Ky program deri më tani ka financuar 129 projekte në të gjithë Shqipërinë me një vlerë prej 27.2 milion dhe me një impakt punësimi të konsiderueshëm në të gjithë sektorët kryesorë ekonomikë. Kombinimi i asistencës teknike dhe financiare në funksion të nxitjes së Start up-eve, inovacionit dhe konkurrencës së SME-ve është një model që duhet të vazhdojë të qëndrojë dhe të avancohet. Qeveria Shqiptare i konsideron fondet e kreditimit dhe garantimit të investimeve dhe të eksportit si instrumenta që duhet të ndihmojnë bizneset në uljen e risqeve të investimit në tregjet e brendshme dhe ato ndërkombëtare.



Nxjtja e investimeve vendase dhe të huaja është prioritet i qeverisë shqiptare dhe një element i rëndësishëm në këtë aspekt është një kuadër ligjor që krijon për investorët siguri dhe të drejtat themelore të nevojshme. Këshilli i Investimeve, në bashkëpunim me MFE dhe International Finance Corporation (IFC)/BB, organizoi 2 tryeza diskutimi mbi Draft-Ligjin e Unifikuar të Investimeve, i cili më parë ishte publikuar për konsultimi publik, ku morën pjesë rreth 40 përfaqësues nga dhomat e tregtisë, shoqata biznesi të huaja dhe vendase, studio ligjore si dhe përfaqësues tregtar të ambasadave të huaja në vend. Komentet e dërguara nga përfaqësuesit e biznesit, ekspertët e IFC në bashkëpunim me grupin e punës, do të pasqyrohen në një matricë me interpretimet përkatëse, e cila më tej të ndahet me palët e interesuara.



Shqipëria ka prezantuar politikat e saj ekonomike dhe sociale me fokus gjinor në Forumin e Kombeve të Bashkuara mbi Shërbimet Publike (UNPSF), në Azerbajxhan, me temë "Realizimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm përmes ofrimit të Shërbimeve Efektive, Transformimit Inovativ dhe Institucioneve të Përgjegjshme". Ministria e Financave dhe Ekonomisë u përfaqësua në këtë Forum nga Zv.Ministria znj. Dajna Sorensen, e cila ishte pjesë e diskutimeve në panelin "Promovimi i shërbimeve publike me përgjegjësi gjinore për arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm". Në diskutimin e saj, znj. Sorensen u fokusua te Buxheti Gjnor, politikat sociale dhe ekonomike me fokus gjinor, dhe roli udhëheqës i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.



Shërbimet e Administratës Tatimore që ofrohen online nëpërmjet portalit e-Albania përbëjnë më shumë se 80 % të totalit, krahasuar me të njëjtat shërbime që ofrohen në sportelet e shërbimit për tatimpaguesit. Për muajin maj, janë më shumë se 19 500 shërbime (vërtetime, çertifikatë rezidence, konfirmim listëpagesash, etj), të cilat tatimpaguesit dhe individët i kanë përfutur nëpërmjet portalit, ndërkohë që në sportelet e shërbimit janë lëshuar rreth 2700 dokumenta. E shprehur në përqindje, shërbimet online zënë 88%, krahasuar me 12% shërbime në sportel, ndërsa në tërësi për 5 mujorin e parë të këtij viti, raporti është 81% me 19% (71.500 me 16.500). Ofrimi i shumë shërbimeve në rrugë elektronike ka bërë që të reduktohen ndjeshëm kontaktet e drejtpërdrejta me administratën, radhët e gjata dhe koha e pritjes.



Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi mes tyre, në praninë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, z. Endrit Shala dhe përfaqësuesve përkatës të institucioneve. Nevoja për këtë marrëveshje midis dy institucioneve lindi duke konsideruar rëndësinë e regjistrimit të bizneseve për zhvillimin e ekonomisë, promovimin e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë në një kohë kur teknologjia dhe inovacioni kanë marrë një rëndësi të jashtëzakonshme. Shumë i rëndësishëm është edhe shkëmbimi i informacionit, praktikave më të mira, si dhe rritja e fushatave të ndërgjegjësimit publik në mënyrë që qajsa ndaj subjekteve të jetë sa më cilësore.



755 persona janë punësuar përmes zyrave të Punës në gjithë vendin gjatë periudhës 21-27 qershor 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Durrësit me 111 persona, ndjekur nga qarku i Beratit me 105 persona, qarku i Vlorës me 83 persona, qarku i Shkodrës me 79 persona, etj.